



Prishtinë: 24 qershor 2008  
Kodi i ZRRE-së: D\_092\_2008  
Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_R\_96\_06\_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_R\_96\_06\_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

**Në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2008 nxori këtë:**

### VENDIM

**PRANOHET** ankesa e të licencuarit KOSTT SH.A, si në arsyet e paraqitura në rekomandim e DMK të ZRRE-së.

### Arsyetim

1. I licencuari KOSTT në kërkesën e tij drejtuar në DMK të ZRRE-së me datë 03 prill 2008 ka kërkuar që i licencuari TGC Inc. të respektojë detyrimet që dalin nga Rregullat e Tregut dhe nga Marrëveshja Kornizë për Implementimin e Rregullave të Tregut e nënshkruar nga të licencuarit.
2. Me datë 21 dhjetor 2006 Bordi i ZRRE-së ka miratuar Rregullat Tranzitore të Tregut të kërkuara nga KOSTT-i. Përgatitja e Rregullave Tranzitore të Tregut ka qenë obligim ligjor i KOSTT-it bazuar në Nenin 27.5 të ligjit për Energjinë Elektrike, dhe në licencën e lëshuar nga ZRRE: ERO\_Li\_16/6.  
**Provë:** Vendimi D\_28\_2006 i Bordit të ZRRE-së.
3. Me datë 20 mars 2007 Palët pjesëmarrëse të tregut të energjisë në Kosovë zbatuese të Rregullave Tranzitore të Tregut kanë nënshkruar Marrëveshjen Kornizë me të cilën janë obliguar për zbatimin e Rregullave Tranzitore të Tregut nga data 1 prill 2007. Nënshkruer i kësaj marrëveshje është edhe TGC Inc.  
**Provë:** Marrëveshja Kornizë për Zbatimin e Rregullave Tranzitore të Tregut
4. TGC Inc. Ka kontratë për shitjen e energjisë elektrike me KEK Sh.A. me çmim 40 €/MWh e cila kontratë është bërë kur shërbimet për të cilat kërkohet pagesa nga KOSTT kanë qenë të integruara në KEK përfshirë edhe shërbimet për OST dhe OT.  
**Provë:** Kontrata KEK – TGC Inc.
5. Me datë 29 qershor 2008 është mbajtur Takimi KOSTT – ZRRE – TGC Inc, në të cilën janë diskutuar për shërbimet të cilat KOSTT i kryen për të gjithë akterët e tregut dhe arsyet se pse këta akterë i detyrohen KOSTT-it.  
**Provë:** Minutat e Takimit



6. Me datë 10 mars 2008 është mbajtur takimi në KOSTT në mes të përfaqësuesve të KOSTT-it dhe TGC Inc. Në takim sërish janë diskutuar obligimet e TGC Inc ndaj KOSTT-it. Përfaqësuesi i TGC Inc. ka shpreh mendimin se këto obligime duhet t'i adresohen KEK-ut, KOSTT-i nuk kishte ndonjë kundërshtim që këto obligime ti kalojnë KEK-ut por kërkoi një konfirmim me shkrim nga KEK-u në afat prej dy javëve. Edhe pas skadimit të këtij afati KOSTT nuk ka marrë ndonjë konfirmim se KEK-u i merr këto obligime.
7. DMK e ZRRE duke u bazuar në Rregullat Tranzitore të Tregut dhe Obligimet e Prodhuesve (gjeneratorëve të lidhur në sistem) që dalin nga këto rregulla (Neni 59, Neni 60), dhe bazuar në faktin se TGC Inc. është nënshkruese e Marrëveshjes Kornizë me çka ajo ka marrë obligimet dhe detyrimet për pagesën e shërbimeve që kryhen nga KOSTT-i, i rekomandon Bordit që të pranojë ankesën e KOSTT-it dhe të obligojë TGC Inc. që të paguajë këto shërbime ndaj KOSTT-it.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimi të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së:

\_\_\_\_\_  
Ali Hamiti, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Theranda Beqiri, Anëtare

\_\_\_\_\_  
Nysret Avdiu, Anëtar